



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-II-14-0017

N. D, Deçan.

Paditësi

Përfaqësuar nga Av M. B, Deçan.

Kundër:

E Paditura/Ankuesja

Sha. “K” –D në Pejë, . “N”Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Deçan C.nr.103/2004 të datës 15.10.2010, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 16/07/2020, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Kolegji i Apelit shpallet jo kompetent për të gjykuar ankesën e të paditurës.

2. Ankesa kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Deçan C.nr.103/2004 të datës 15.10.2010i përcillet Gjykatës së Apelit në Prishtinë për gjykim.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datë 15 prill 2004, paditësi dorëzoi në Gjykatën Komunale në Deçan një padi për kompensim dëmi ndaj të paditurës K. Paditësi ka pohuar se i është djegur e tërë shtëpia e tij njëkatëshe, e ndërtuar dhe kompletuar në tërësi sipas standardeve bashkëkohore me të gjitha pajisjet teknike dhe familjare, për shkak të rrymës. Paditësit meqenëse i është shkaktuar një dëm i madh, ka kërkuar nga gjykata që ekspertët e elektros dhe ndërtimtarisë të dalin në vendin e ngjarjes dhe të bëhet vlerësimi i objektit të djegur.

Në bazë të procesverbalit për shqyrtimin kryesor, nr.33/2004 të datës 16.04.2004, shihet se Gjykata ka dalë në vend shikim së bashku me ekspertin e ndërtimtarisë dhe ekspertin e elektros. Pas shikimit të vendit të ngjarjes, Gjykata ka urdhëruar ekspertët që në afat prej 8 ditësh të paraqesin nga eksperti i ndërtimtarisë ekspertizën e dëmit të shkaktuar ndërsa nga eksperti i elektros shkaktarin e djegies së shtëpisë.

Me datë 16 prill 2004 eksperti i elektros I L, ka dorëzuar ekspertizën e tij në të cilën deklaroi rrjedhën se si ka ardhur deri tek djegia e shtëpisë përmes rrymës elektrike dhe se vlera e dëmeve në instalime elektrike është rreth 2500 euro.

Me datë 23 prill 2004, eksperti i ndërtimtarisë Xh.G ka dorëzuar ekspertizën e tij në të cilën deklaroi se objekti është shtëpi individuale e banimit, ka 4 dhoma, 1 koridor, 1 banjo, me dimensione 14.00 x 10.25, i ndërtuar nga materialet aktuale të ndërtimit që gjenden në treg dhe para shpërthimit të zjarrit ishte në tërësi e mobiluar. Sipas ekspertizës dëmi i shkaktuar nga zjarri në të gjithë objektin me të gjitha orenditë brenda kap vlerën prej 16.872.00 euro.

Më 30/08/2004 Gjykatat komunale në Deçan me Aktvendim, shpallet jokompetente nëpikëpamjelëndore dhe lenden e dërgon në DHPGJS për gjykim.

Me datë 01 shkurt 2007, paditësi e dorëzon një parashtrësë me të cilën e cakton çmimin e kompensimit të dëmit, në shumë prej 19.320 euro.

Me datë 01 prill 2008, eksperti i ndërtimtarisë dorëzon llogaritjen e shkallës së amortizimit për lëndën në fjalë. Në bazë të kësaj llogaritje shihet se vlera e mbetur për pagesë është 6.017,40 euro.

Me datë 15 tetor 2010, Gjykata Komunale në Deçan mori Aktgjykimin C.nr. 103/2004 me të cilin e aprovon pjesërisht kërkesë padinë e paditësit, e detyron të paditurën që paditësit në emër të dëmit të shkaktuar për djegien e shtëpisë t'ia paguajë shumën prej 3000 euro me kamatë ligjore duke llogaritur nga data 15.05.2004 e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 787,80 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, ndërsa pjesën e kërkesë padisë së paditësit për kompensimin për dëmin e shkaktuar në shumë prej 3.017,40 euro e ka refuzuar si të pabazuar.

Aktgjykimi Aktgjykimin C.nr. 103/2004 i servohetë paditurës me daton 25/10/2010 ndërsa paditësit me 25/10/2010.

Me datë 08 nëntor 2010, e paditura KEK (në tekstin e mëtejme ankuesja) ka bërë ankesë ndaj Aktgjyimit të Gjykatës Komunale në Deçan C.nr. 103/04 të datës 15.10.2010 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore. Në ankesë ankuesja ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar është kundërligjor dhe i paqëndrueshëm dhe si i tillë duhet të priset. Ankuesja gjithashtu ka pohuar se edhe gjatë procedurës është deklaruar se e paditura nuk është fajtores për dëmin e shkaktuar, dhe se ekspertiza e ekspertit të elektros është e paqëndrueshme, jo bindëse dhe në asnjë mënyrë nuk ka mundur të vërtetojë se shkaktari i zjarrit të ketë qenë defekti në rrjetin e të paditurës, pasi që konstatimet e tij janë kontradiktore me rregullat teknike. Tutje ankuesja ka pretenduar se paditësit i mungon baza e kërkesë padisë. Ankuesja ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet ankesa e saj, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Ankesa është regjistruar në Gjykatën e Qarkut në Pejë si Ac.nr. 418/2010, e cila me datë 28.12.2010 lëndën e bartë tek DHPGJS-ja për të vendosur si gjykatë kompetente.

Lënda në DHPGJS merr numrin SCA-10-0110.

Me datë 09 korrik 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktvendimin SCA-10-0110, lëndën e mbyll dhe ia dërgon Kolegjit të Apelit si organ kompetent për të vendosur më tutje.

Ankesa e të paditurës i dorëzohet paditësit më 12/06/2020.

Më 06/07/2020 paditësi parashtrroi përgjigje ndaj ankesë. Ai kërkoi që ankesa e te paditurës të refuzohet si e pa bazuar.

Arsvetimi ligjor

Në bazë të nenit 69 Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Mungesa e juridiksionit të DHPGJS-së

Juridiksioni i DHPGJS është i rregulluar me Nenin 5 të Ligjit nr. 06/L-086 (nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-033) të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit kurse neni 6 i LDHP(Neni 5 i LDHP) përcakton se kush mund të jetë Paditës dhe i Paditur në procedurën para DHPGJS.

Neni 5, paragrafi 1.4, i LDHP thotë se DHPGJS ka kompetencë ekskluzive mbi një padi kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që supozohet të ketë lindur gjatë ose para kohës kur Ndërmarrja apo Korporata e tillë është apo ishte subjekt i autoritetit administrativ i AKM-së, Agjencia.

Sipas Nenit 2 të LDHP termi "Ndërmarrje" i përdorur në këtë ligj ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 3 të Ligjit No.03/L-067, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej: Ligji për AKP).

Neni 3 i Ligjit për AKP-së thotë se termi " Ndërmarrje" nënkupton një ndërmarrje mbi të cilën Agjencia ka kompetenca sipas Nenit 5.1 (a) (i) të Ligjit të njëjtë.

Sipas Nenit 5.1 (a) (i) të Ligjit për AKP-së, *"Agjencia ka autoritetin të administrojë ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar Transformimit"*.

Neni 3.1 i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për NP) i hyrë në fuqi më 15 Qershor 2008, thekson se të gjitha ndërmarrjet e radhitura në Listën 1 e cila i është bashkangjitur këtij ligji janë, Ndërmarrje Publike Qendrore. Të gjitha NP

Qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës. E Paditura në rastin në fjalë është NP Qendrore, e radhitur në pikën 1 në Listën 1. Pasi që i Paditur është një NP dhe jo një Ndërmarrje apo Korporatë, siç kërkohet në Nenin 5, paragrafi 1.4 i LDHP, e as një i Paditur, siç kërkohet në Nenin 6, paragrafi 2 i LDHP, DHPGJS nuk ka juridiksion në këtë rast.

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për Ndërmarrjet publike: "Qeveria do të ketë kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore (...)"

Për më tepër, ajo është e rregulluar në Nenin 13.1 Ligjit për Ndërmarrjet publike se: Përveç nëse shprehimisht është përcaktuar ndryshe në këtë ligj, të gjitha NP si dhe zyrtarët dhe drejtorët e tyre, pa asnjë përjashtim, i nënshtrohen ligjeve, rregulloreve dhe akteve nënligjore të cilat i rregullojnë shoqëritë tregtare në pronësi private. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, shprehimisht përcaktohet se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka kompetencën ekskluzive për të gjitha procedurat e paaftësisë paguese (insolencës), likuidimit ose riorganizimit të një NP.

Rasti i tanishëm, megjithatë, nuk bie nën rregullat e jashtëzakonshme të përcaktuara më lart dhe për këtë arsye DHPGJS nuk ka juridiksion mbi të.

Kolegji i Apelit në bazë të nenit 18 të ligjit mbi gjykatat ankesën e të paditurës të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Deçan C.nr.103/2004 të datës 55 tetor 2010, ka vendosur ta kthejw për shqyrtim në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Shpenzimet gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën pasi që lista e taksave gjyqësore që ka hyrë në fuqi për DHPGJS-në më 27 mars 2014 nuk mund të aplikohet për rastet në pritje në mënyrë retroaktive.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit më 16/07/2020

Ilmi Bajrami , Gjyqtar Kryesue

